

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Lulluni kryetar, Isa Kelmendi dhe Albert Zogaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Sh.H. nga Prizreni, Rr. "...", nr.II/2, të cilin me autorizim e përfaqëson N.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Hekurudha e Kosovës "INFRAKOS", sh.a., me seli në Fushë Kosovë, për anulimin e njoftimit për shkak të largimit nga puna, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.722/2013 të dt. 11.09.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt.10.01.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit Sh.H. nga Prizreni, Rr. "...", nr.II/2, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.722/2013 i dt.11.09.2014, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në paragrafin I të dispozitivit, refuzohet kërkesëpadia e paditësit Sh.H. nga Prizreni, Rr. "...", nr. II/2, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Njoftimi nr.90 të datës 07.02.2001, i sjell nga Hekurudha e Kosovës "INFRAKOS", sh.a., me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si i kundërligjshëm, të detyrohet e paditura Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS" sh.a., që paditësit t'ia njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që nga dita e largimit me datën 07.02.2001, e deri më datën e pensionimit 25.05.2012, të detyrohet që paditësit t'ia kompensoj fitimin e humbur në emër të pagave të paguara prej ditës së largimit 01.03.2001 deri me ditën e pensionimit 25.05.2012, të ardhurat neto në shumë prej 27,832,12 € me kamatë të llogaritur sipas arritjeve mujore për pagesë prej ditës së ushtrimit të padisë me datë 30.05.2001 deri me 30.06.2014, me normë vjetore prej 3,5 %, në shumë prej 7,618.14 €, e që arrin vlerën e përgjithshme prej 35,450.26 €, të detyrohet e paditura që paditësit t'i paguaj kamatën në lartësi prej 8 % në shumë prej 35,450.26 €, duke filluar nga data 01.07.2014, deri në ditën e pagesës definitive, të detyrohet e paditura që në emër të kontributit pensional nga këto të ardhura t'i paguaj paditësit shumën prej 2.716,50 €, të cilën paditësi do ta kishte realizuar në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës ditën e pensionimit me datë 25.02.2012, me kamatë prej 3.5 % nga data 25.05.2012, ndërsa nga data 01.01.2013, me kamatë prej 8 %, deri në ditën e pagesës definitive si dhe të obligohet e paditura që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 2.422,60 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën ekzekutim të përmbarimit ligjor, si e pa bazuar. Me të njëjtin aktgjykim në paragrafin II të dispozitivit, është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqit ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi ose të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura, me propozim që bazuar në nenin 391. f), të LPK-së, padia e paditësit në këtë çështje juridike të hudhet poshtë si e pasafatshme.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe të përgjigjes në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësi padinë e paraqitur në gjykatë e ka precizuar me parashtresën e datës 02.07.2014, me të cilën ka kërkuar që, të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, të anulohet Njoftimi nr.90 i datës 07.02.2001, i sjellë nga e paditura, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe që paditësit t'ia njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, nga dita e largimit e deri në pensionimin e tij me datën 25.05.2012, si dhe kërkesat tjera për fitimin e humbur dhe kamatën ligjore si dhe kontributet pensionale, me detaje të tjera të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar.

Sipas paditësit përkatësisht të autorizuarit të tij, paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në vendin e punës ndërrues në Stacionin Hekurudhor në Prizren që nga viti 1969, në punë dhe detyra të punës të komercialistit të transportit-arkatar i Stacionit. Pas përfundimit të luftës, paditësi është kthyer në vendin e punës ku ka punuar më parë. Më datën 24.08.1999, është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit për riintegrimin e ndërmarrjes së transportit hekurudhor, e me këtë edhe të gjithë punëtorëve. Paditësit nuk i është dorëzuar akti individual për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në anën tjetër kur e ka marr njoftimin nr. 90 të datës 07.02.2001, ka ushtruar ankesë kolektive në Bordin e Hekurudhave të Kosovës më datën 08.05.2001. Sipas paditësit, e paditura ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike, ndërsa me rastin e largimit të paditësit nga puna, e paditura nuk ka zhvilluar asnjë procedurë ligjore, ndërsa paditësit nuk i ka dorëzuar asnjë vendim për largim, duke e konsideruar Njoftimin e sipër cekur për largimin e paditësit nga puna, pa bazë ligjore.

I autorizuari i të paditurës, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe të ushtruar jashtë afatit ligjor, duke theksuar se paditësi Njoftimin nr.90 e ka pranuar me datën 07.02.2001, ndërsa ankesën tek e paditura me nr.529 e ka ushtruar me datën 08.05.2001. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, paditësi së bashku me 29 punëtor të tjerë të Stacionit Hekurudhor në Prizren, nuk ka qenë fare i përfshirë në sistemim të përkohshëm tek e paditura, nuk ka pasur ndonjë akt apo kontratë për sistemim të tij, sepse linja hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Xërxë-Prizren, është mbyllur, ndërsa vendi i punës në të cilin ka punuar paditësi me punëtorët tjerë, është shuar në tërësi dhe nuk ekziston. Lidhur me këtë ka paraqitur Njoftimin në lidhje me statusin e paditësit nr. 271 të datës 26.03.2014, ku vërtetohet se paditësi, fare nuk ka qenë në sistemimin e përkohshëm tek e paditura. Pra, Njoftimi nuk ka të bëjë me paditësin si punëtor në asistencë, por ka të bëjë me 194 punëtor të tjerë të cilët e paditura i ka dërguar në pritje të pensionimit të parakohshëm, ku dëshmohet se paditësi fare nuk ka qenë i sistemuar tek e paditura pas vitit 1999. Ka propozuar refuzimin e padisë si të pasafatshme ,ose të refuzohet në mungesë të legjitimitetit pasiv.

Gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet, për shkak të mungesës të legjitimacionit real pasiv të paditurës. Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike, nga aplikacioni i regjistrimit me nr. të fletëparaqitjes 09-00880 të dt. 24.08.1999 ceket se kjo ndërmarrje regjistrohet si Hekurudha të UNMIK-ut, ndërsa nga regjistri i punëtorëve për paga për muajin mars 2001 si titull i regjistrimit është Hekurudhat e UNMIK-ut, dhe ka vërtetuar faktin se Hekurudhat e Kosovës ka administruar UNMIK-u, dhe se Hekurudhat e Kosovës nuk kanë ekzistuar si subjekt afarist i pa varur. Pastaj nga Cerifikata nr.8055903 dt.27.08.02 është vërtetuar fakti se Hekurudha regjistrohet si N.P.SH. Hekurudhat e UNMIK-ut.

Nga gjithë kjo sipas gjykatës ka rezultuar se e paditura menjëherë pas Luftës të vitit 1999 nuk ka ekzistuar si subjekt juridik, por me Hekurudha ka administruar dhe menaxhuar UNMIK-u, i cili në vitin 2002 është regjistruar si subjekt afarist. Ndërkaq nga Certifikata e regjistrimit nr.70325327 të datës 23.12.2005 është vërtetuar se po në këtë datë është bërë bartja e administrimit dhe e menaxhimit të Hekurudhave nga UNMIK-u në Hekurudha të Kosovës dhe kjo e fundit Regjistrohet si Hekurudhat e Kosovës sh.a. Nga Çertifikata e biznesit nr.70325327 dt. 23.08.2011 inkorporohet si Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-Infrakos sh.a., dhe në fund gjykata ka ardhë në përfundim se, në këtë çështje juridike nuk mund të jetë si palë e paditur Hekurudhat e Kosovës “INFRAKOS”, e as Hekurudhat e UNMIK-ut, sepse me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 të datës 18.08.2000 është përcaktuar se UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuria e tij janë të liruara nga çfarëdo procesi ligjor. Kështu që, gjykata e shkallës së parë nuk është lëshuar në vlerësimin e provave materiale por bazuar në dispozitat e sipër cekura si dhe nenin 450 dhe 143 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se, pretendimet ankimore të përfaqësuesit të paditësit, lidhur me atë se, aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka marr aktgjykimin e atakuar, i cili sipas kolegjit të Gjykatës së Apelit, është i drejtë dhe i ligjshëm, nga se në të janë dhënë arsyet konkrete për faktet vendimtare, duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të tillë, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen çështjes juridike të paditësit.

Vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e aprovon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK, për të cilat pa të drejtë pretendohet në ankesë dhe se në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale, e për të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, konform nenit 194 të LPK. Pra aktgjykimi i atakuar është i qartë, nuk është konfuz, e as kontradiktor në vetvete, siç pa të drejtë pretendohet me ankesë. Është fakt se UNMIK-u dhe KFOR-i nuk regjistrohen në regjistrat e përkohshëm të bizneseve afariste, por siç dihet në periudhën kontestuese i kanë administruar Hekurudhat në Kosovë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjykata e shkallës së parë, drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale, kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit, megjithatë, duhet të refuzohet si e bazuar, për të cilin refuzim ka dhënë arsye të mjaftueshme në pjesën arsyetuese të aktgjykimit të atakuar, të cilat e kanë shtyrë gjykatën e shkallës së parë për një vendosje të tillë. Pra, pretendimi ankimor i paditësit se, aktgjykimi është me të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe se dispozitivi është në kundërshtim me arsyet e tij dhe arsyet e treguara në kundërshtim me faktet vendimtare që dalin nga përmbajtja e dokumenteve, janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse gjykata e shkallës së parë ka përpiluar dispozitiv të qartë, i cili nuk ka ndonjë të metë e cila do të shtynte gjykatën e shkallës së dytë, për të marr ndonjë vendim ndryshe nga ai të cilin e ka marr gjykata e shkallës së parë.

Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë për mungesë të legjitimacionit pasiv të të paditurës, e më vonë përfundon se si palë e paditur nuk mund të jenë Hekurudhat e Kosovës e as Hekurudhat e UNMIK-ut, sepse pretendimi i tillë në situatën konkrete është irelevant dhe nuk ka ndonjë peshë të caktuar, që do të ndikonte që gjykata e shkallës së dytë të ndryshoj përkatësisht të prish aktgjykimin e atakuar.

Është fakt se kontesti ka filluar në bazë të Njoftimit nr. 90 të datës 07.02.2001, të lëshuar nga NPSH “Hekurudhat e Kosovës”, mirëpo, në këtë periudhë kontestuese është fakt notor se Hekurudhat e Kosovës nuk kanë qenë të regjistruara, dhe se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është thirrur në legjitimacionin pasiv të të paditurës.

Gjithashtu, edhe pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë nuk ka marr në konsiderim Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev-Mlc.nr.233/11 të datës 08.05.2013, në kontestin identik se Hekurudhat e UNMIK-ut nuk mund të paditen në kontestet nga marrëdhënia e punës, mirëpo, në situatën e rastit konkret, kjo nuk është përjashtuar, mirëpo me kusht që paditësi të jetë punëtor gjatë periudhës kontestuese tek Hekurudhat në fjalë, çka në rastin konkret nga pala paditëse nuk është argumentuar me ndonjë provë konkrete të bazuar. Gjithashtu, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore kur i referohet Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.46/2013 të datës 17.07.2014, sepse kur shikohet aktvendimi i tillë, i njëjti ka të bëjë me padi të pa afatshme, e jo me padi për të cilën është vendosur në mënyrë meritore.

Meqë, aktgjykimi i atakuar është marr pas një vërtetimi të plotë të gjendjes faktike, duke mos pasur ndonjë shkelje esenciale të dispozitave procedurës kontestimore, për të cilën pa të drejtë pretendohet nga përfaqësuesi i paditësit, si dhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, atëherë Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje e akcepton edhe Gjykata e Apelit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par. 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË
Ac.nr. 4729/2014 me dt. 10.01.2017

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Lulluni